

Transparencë për Industrinë Nxjerrëse dhe realizohet në përputhje me kërkesat e kësaj nisme.

4. Formulari i raportimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nga kompanitë minerare është i përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Formulari i raportimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nga institucionet shtetërore është i përcaktuar në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse duhet të përmbajë informacion në plotësim të kushteve të mëposhtme:

- a) Përfshirjen e shoqërisë civile, të medias e të komuniteteve të rajoneve minerare në procesin e hartimit e të diskutimit të tij.
- b) Përmirësimet ligjore për heqjen e pengesave për zbatimin e kësaj nisme.
- c) Përfshirjen, në mënyrë progresive, të të gjitha kompanive që kryejnë veprimtari minerare.
- ç) Garantimin që raportet e kompanive të jenë sipas standardeve ndërkombëtare dhe EITI-së.
- d) Garantimin që raportet e institucioneve shtetërore të jenë sipas standardeve ndërkombëtare dhe EITI-së.
- dh) Duhet të realizohet në përputhje me kërkesat e auditimit, të përcaktuara nga sekretariati i EITI-së dhe të marrë në konsideratë sugjerimet e këtij auditimi.
- e) Duhet të përditësohet nga Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

7. Një ekspert i pavarur, i përzgjedhur në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe kërkesat e Sekretariatit Ndërkombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), harton raportin përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

8. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse miratohet nga grupi ndërinstitucional i punës i kësaj nisme, i krijuar me urdhrin nr.156, datë 27.12.2008, të Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës, për ndjekjen e procedurave të kandidimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)”.

9. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse diskutohet me shoqërinë civile, median dhe komunitetet e rajoneve


minerare dhe reflekton opinionin e tyre në raportet pasardhëse.

10. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse auditohet nga ekspertë të pavarur, të përzgjedhur sipas procedurave tenderuese në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me kërkesat e sekretariatit të EITI-së.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".


KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

**MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

NASIP NAÇO

~~Në mungesë dhe me porosi~~

NERITAN ALIBALI

Aneksi 1

Forma e Raportimit për NTIN (EITI)—Shqipëria			
A. Forma e Raportimit nga Kompanitë e Industrisë Minerare			
Vendi:		Kompania:	
NIPT:		Adresa:	
Kodi ekonomik i veprimtarisë:		Tel:	
		E-mail:	
Periudha e raportimit:		Viti:	
Informacione të detyrueshme	Referenca në bilancin e kompanisë	Volume	Vlera (në lek)
Të ardhurat për shtetin (Taksat) që paguhen nga kompanitë			
1a) Tatim Fitimi			
1b) Renta Minerare			
	- në lek		
	- në natyre		
1c) pagesa që lidhen me detyrimet e lejes minerare, pagesa të tjera të lidhura me procedurat e licencimit(specifikoje)			
1d) Bonuse të dhëna , bonuse për prodhimin			
1e) Sigurimi jetës,			
1f) Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore			
1g) Pagesa të tjera për autoritetet lokale të specifikuar a) <i>Taksë gjelbërimi</i> b) <i>Taksë Tabele</i> c) <i>Taksë Pastrimi</i> d) <i>Tatim pasurie</i>			
1 h) TAP (Tatim mbi të ardhurat Personale) a) <i>Tatim i të ardhurave nga punesimi</i> b) <i>Tatime mbi të Ardhurat e mbajtur në Burim</i> c) <i>Tatimi mbi të Ardhurat nga Devidentet dhe Aksionet</i>			
1 i) TVSH			
1 j) Taksa doganore			

Të ardhura të tjera (Informacion vullnetar)	Ref	Volume	Vlera (në lek)

Për nënshkrim nga nëpunësi përgjegjës i Kompanisë së Industrisë Minerare

Ne njohim përgjegjësinë tonë se të dhënat e prezantuara në raportin e mësipërm janë në përputhje me të dhënat e regjistrave tanë me përjashtim të:

Emri

Firma

Vula

_____ ; _____ ;
Pozicioni _____ . **Date./.../20.....**

Aneksi 2

Forma e Raportimit për NTIN (EITI)—Shqipëria			
A. Forma e Raportimit nga institucionet shtetërore të taksave			
Vendi:	Kompania:		
NIPT: Kodi ekonomik i veprimtarisë:	Adresa: Tel: E-mail:		
Periudha e raportimit:	Viti:		
Informacione të detyrueshme	Referenca në bilancin e kompanisë	Volume	Vlera (në lek)
Të ardhurat për shtetin (Taksat) që paguhen nga kompanitë			
Ia) Tatim Fitimi			
Ib) Renta Minerare			
	- në lek		
	- në natyre		
Ic) pagesa për licencën dhe rinovimet, sipërfaqen e zonës minerare, pagesa të tjera të lidhura me procedurat e licencimit (specifikojë)			
Id) Bonuse të dhëna, bonuse për prodhimin			
Ie) Sigurimi jetës.			
If) Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore			
I g) Pagesa të tjera për autoritetet lokale të specifikuar e) Taksë gjelbërimit f) Taksë Tabele g) Taksë Pastrimi h) Tatim pasurie			
I h) TAP (Tatim mbi të ardhurat Personale) d) Tatim i të ardhurave nga punesimi e) Tatime mbi të Ardhurat e mbajtur në Burim f) Tatimi mbi të Ardhurat nga Devidentet dhe Aksionet			
I i) TVSH			
I j) Taksë doganore			

Të ardhura të tjera (Informacion vullnetar)	Ref	Volume	Vlera (në lek)

Për nënshkrim nga nëpunësi përgjegjës i Institucionit Shtetëror të Taksave

Ne njohim përgjegjësinë tonë, se të dhënat e prezantuara në raportin e mësipërm janë në përputhje me të dhënat e regjistrave tanë me përjashtim të:

Emri _____ : _____ : _____
 Pozicioni _____ Date../.../20...

NR.PROT.976/1
DATË 30.3.2011

MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE (AKBN)
SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR (SHGJSH)
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA
Sekretar i Përgjithshëm

